



MËRITË I NDAJNË NJERËZIT, QË KANË SHUMË NEVOJË PËR NJËRI - TJETRIN

Mëria është një gjendje e shëmtuar zemërake, që shkaktohet mes njerëzve, për shkak të hatërmbetjeve, inateve apo zënkave të ndryshme. T'i mbash mëri dikujt, do të thotë jo vetëm të mos ruash marrëdhëniet me këtë person, por shpesh edhe të ushqesh për të ndjenjën e padëshiruar të urrejtjes.

Por a ka më keq se sa urrejtja? Dhe për më tepër, kur fryma mbytëse e saj i imponohet edhe personave të tjerë rreth nesh? Urrejtja është totalisht e kundërta e së ëmblës dashuri. E nëse nuk ka më keq se urrejtja, padyshim, s'ka më mirë se sa dashuria.

Të duash është virtyt. Dashuria është një dhunti, një talent, që jo të gjithë e kanë. Ajo është aftësia, që kanë njerëzit për të shprehur veten, për t'i bërë njerëzit, që duan të lumtur, për të dhënë më të mirën e tyre, për tu ndier të realizuar dhe të plotësuar. Po nga buron dashuria?

Dashuria rrjedh nëpër gjakun e zjarrtë të venave, ashtu si një lumë i pashtershëm me ujë të kristaltë e të qartë, që nuk është prekur e ndotur nga veset dhe ligësia. Kjo ndjenjë rrjedh prej më të fuqishmit, prej më të pasurit burim: zemrës së dëlirë dhe ushqen po atë me pastërti, mirësi e bukuri shpirtërore.

Dashuria nuk është thjesht një ndjenjë. Ajo është një ideal, një bindje, një qëllim, një nevojë. Nevojë për t'i pasur pranë njerëzit e dashur. Kjo sepse dashuria është një zjarr që ngroh, një zjarr që bashkon. Kurse lumturia është rrjedhimi i dashurisë.

Jeta jonë ka kuptim, kur ne provojmë të marrim gëzim e lumturi për veprat që ne bëjmë, për misionet që përmbushim në mënyrë të suksesshme, për mirësinë që shpërndajmë dhe dhurojmë tek të tjerët. Në qoftë se s'do të kishte dashuri, atëherë lumturia s'do të ekzistonte. Mungesa e lumturisë vjen nga paaftësia. Po, po. Nga paaftësia për të dashur.

Mund të thuhet, për shembull, se një njeri është i palumtur, sepse ai ka humbur njerëzit, që do. Jo, ai kurrësi nuk është i tillë. Përkundrazi, ai ndjen dhimbje. Kjo dhimbje është një dhimbje e madhe, që vjen nga humbja e një dashurie të madhe. Por, ky njeri nuk është aspak i palumtur, sepse ai, gjatë jetës së tij, ka arritur të gjejë virtytin më të lartë e fisnik te vetja e tij: **dashurinë**.

I palumtur, i shkretë, i mjerë, i vetmuar është ai që urren; ai që mban mëri; ai që s'di të tolerojë dhe vazhdon t'i qëndrojë besnik bindjes së tij anakronike, të vjetëruar, të ndryshkur, të pluhurosur nga grimcat e kohës së bukur, që s'erdhi kurrë, por u zëvendësua nga veli i harresës. E nëse dashuria ishte një zjarr, që i bashkonte shpirtrat human, e kundërta e saj, mëria, i ndan ata, i mban sa më larg njëri-tjetrit.

Mëria është një mur i madh e i pafund, i ndërtuar në kufijtë e zemrave, në kufijtë e dashurive njerëzore. Po, duke qenë se është një mur i ndërtuar nga mendja e njeriut, ne mund ta gjejmë forcën dhe ta shembim atë. Nëse çdo ditë e zbehim këtë mur, atëherë ai do të shndërrohet në një perde të lehtë për tu hapur e për të parë se ç'ka përtej saj. Është zona përtej kufirit. Aty bota rrëzëllen me të gjithë shkëlqimin dhe dritat e saj dhe jeta lulëzon me të gjithë magjinë e skeptrit të saj të ngjyrave. Aty të gjithë janë të bashkuar e të lumtur.

Pra, padyshim, që mëria i ndan njerëzit. Ajo i destinon ata nëpër cepat më të errët të jetës, në greminat më të thella të saj. Le ta duam njëri-tjetrin, të qëndrojmë të bashkuar, të lumtur, të emancipojmë, të civilizojmë shoqërinë tonë, sepse kemi shumë nevojë të ecim përpara, sepse duhet të ecim përpara. Dhe të ecësh përpara do të thotë ta sfidosh jetën, t'i tregosh asaj, se ti mundesh dhe ke guximin dhe fuqinë e duhur për t'ia dalë mbanë. Kjo arrihet, sigurisht, kur jemi të bashkuar, sepse bashkimi i ndërtuar mbi themelet e dashurisë na bën të pathyeshëm...

K.K